




REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dop. Dop.	DPKI
Nr. i faq Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot Br Prot Prot No	06/1848/20
Data Datum Date	10.09.2020
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 09.09.2020, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-06-1105/20, për zyrtarin e lartë z. Zenel Hisenaj, U.D. Drejtor i Departamentit të Sistemit Informativ Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë, për shkak se zyrtari i lartë e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë z. Zenel Hisenaj, U.D. Drejtor i Departamentit të Sistemit Informativ Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë dhe njëkohësisht person i autorizuar në bizneset private "Naturlig Gronn L.L.C" dhe "Zenel Hisenaj B.I", është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Agjencia kundër Korrupsionit, fillimisht e ka njoftuar zyrtarin e lartë me një shkresë zyrtare për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari i lartë është njoftuar se gjatë ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik, nuk



mund të ushtroj edhe funksion menaxhues në bizneset private të cituara më lartë sepse kjo është e ndaluar me neni 13 (paragrafi 1) të Ligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit, në të cilën thuhet:

1. *Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit.*

Ndërsa me nenin 19 të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit parashihen masat për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave. Dispozitat e nenit në fjalë përcaktojnë se:

1. *Në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari sipas rastit dhe rrethanave:*
 - 1.1. *transferon interesin privat dhe të drejtat në drejtimin e ndërmarrjes sipas përcaktimeve të nenit 15 të këtij ligji; [...];*
 - 1.3. *jep dorëheqjen nga detyrat, funksionet ose veprimtaritë që janë në konflikt ose të papajtueshme me funksionin e tij publik;*
 - 1.4. *dorëhiqet nga funksioni publik.*

Zyrtari i lartë, është deklaruar se do të ndërmarr veprime për tu larguar nga funksioni menaxhues, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia e ka pranuar edhe shkresën zyrtare me nr. (06-1743/20), me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë është larguar nga funksioni menaxhues në biznesin privat “Naturlig Gronn L.L.C”, ndërsa ka bërë shuarje vullnetare të biznesit privat “Zenel Hisenaj B.I”.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

